

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
M 98

Avni R. Mulaj

Valbona e kallter

poesi

8JH-1
M198

AVNI R. MULAJ

VALBONA E KALTËR

poezi



13429

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

LIBRUM NEXIVA

38M

AN E AMORIAV

1989

Kopertina nga: Svetllana Strazimiri

Tirazhi 1.500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974

B J E S H K È T

E si mund të hesht, e si mund t'i harroj
bjeshkët e mia, nëna të fëmijnisë sime!

Shtruar në qilima të gjelbër pa fund,
jam endur nëpër to, gjithnjë duke u rritur,
gjithnjë një qafë a një pllajë më tutje.

Natyrë e pafundme me udhë të pafundme!
Dhe kam ndjerë se diçka është formuar tek unë,
prej fëshfërimës së barit, gjethit e halës së pishës,
prej gurgullimës së ujërave, motit të qetë dhe
stuhisë,

prej vëtmisë së shpellave e formës së shkëmbinjve,
prej tingullit të lahutës, zërit të rapsodit,
dhe heshtjes së gurit, mbi të cilin vështrimi im
dallon duar stërgjyshërish duke lëvizur e duke
ngritur
atë diçka të madhe që quhet shqiptare
dhe që s'e shembi dot asgjë.

XHAKETA ME MËNGË TË SHKURTËRA

Shpeshherë e shihnim fotografinë e vëllait me nënën, me babanë e me motrat në mbrëmje, dhe nënës sytë i turbulloshin papritur, dhe sytë e vëllait na shihnin përmallur të gjithë, sepse diku larg i duhej të kalonte dimrin si nxënës me një xhaketë të vjetër me mëngë shumë të shkurtëra, që nuk arrinin krahët t'ia mbulonin plotësisht.

Dhe sytë e nënës nguleshin te llërët e mbeturaj ashtë, oh, ç'i thoshin vallë nënës ato dy duar në heshtje? Kështu atëherë, nënë, kishim shumë zhele ne dhe atdheu që sapo kish fituar lirinë...

Por shpejt u rritëm duke ndarë hallet bashkë me atdhenë

dhe mëngët e xhaketave të plota tanë na rrinë mirë

dhe pas rrudhave e thinjave shohim Shqipërinë industriale.,,

Vëlla, u rritëm, por ajo fotografi na mbeti si
kujtim,
ato dy mëngë të shkurtëra, të dhemshura, të da-
shura.

ia lindet un flampol qđn moq mëdha u qđn V
mëtëtol
sab bi qđnqasellë së këshillës së qđnqasit qđn qđn
qđnqas

KOMUNA E PARISIT

Fjeti Komuna,
në gjinë e saj historia e mbështolli.
Komuna fjeti e lumtur,
më e lumtur seç kish qenë Parisi gjithmonë,
me misteret e tij, për të cilat njihet në botë,
më e lumtur seç kish qenë bota ndonjëherë.
Komuna u varros e pavarrosshme,
Komuna lindi që padrejtësitë të varroste.
Përpara murit të vjetër të urryer të shtypjes,
u pushkatuan komunaret,
fëmijët më të bukur të botës,
dhe më të qeshur dhe më të përgjakur!
E ngelën ashtu në kujtesën e botës,
si vetë drejtësia, të pamposhtur!

NË PRAG TË VITIT TË RI

Kaq shumë fëmijë u shfaqën papritur në qytet,
përzier me kukllat, saqë zor t'i dallosh kukllat
nga fëmijët,
kaq shumë gëzim u shfaq papritur kudo,
saqë zor t'i dallosh të mëdhenjtë nga të vegjlit.
Po fëmijët sot s'përbahen: Viti i Ri, Viti i Ri!
Gëzimi i tyre kërkon të sundoje mbi çdo gjë.
Ata duan të jenë kudo, konduktori nëpër trenat,
duan të ngasin avionët, trenat, nëndetëset.
Fëmijët nëpër dhomat e mbushura me kuklla,
me makina e kafshë të zbutura,
që jetojnë me njerëzit në harmoni.
Dhe qyteti si një xhungël,
ku ndizen në mënyrë përrallore,
miliona llambushka shumëngjyrëshe,
qindra herë fëmijët pyesin: «Kur do të vijë Viti
i Ri?»

T'ju thoni: «Në 12.»
Pyesin sërisht: «Si do të vijë?»

Por asnjë përgjigje s'u ka gjetur shpirtin krejt.
Dhe mua të lumtur më bën ndjenja e tyre,
me të cilën ndjekin akrepin e madh e shajnë të
voglin,
dhe në puqjen e tyre shoh botën e madhe
nën miliona vështrime të fëmijëve...

MOS E LEJO...

Mos e lejo kurrë zemrën të rrahë për gjëra të kota,
sepse nga dashuria e vërtetë ke hequr ca të rracha,
mos hidh kurrë hapa në një rrugë pa qenë i vendosur,
sepse shumë vonë i penduar rëndë do të kthehet,
mos dil kurrë të presësh një vajzë që edhe mund
duhet të mos vijë,
sepse mund të ngelesh i vetëm në një çast që nuk

duhet të ngelësh.

MINATORËVE TË VALBONËS

Unë isha atje në muajt e verës,
dhe ju njoha ashtu siç ishit vetë.
Shqetësohem i ne, poetët, të shkruajmë për ju,
por atë këngë plotësisht ende s'e kemi gjetur.
Tani do ketë rënë atje shumë dëborë,
dhe udha mbi shkëmb drejt galerisë
kalohet sigurisht me zor,
më me zor se nëpër një rresht të poezisë.
Dhe ngushtohet e ngushtohet hapësira,
dhe mbeten vetëm tunelet dhe hapësirat e zem-
rave tuaja.

Uturin tufani i dëborës në Lugun e Thiut
dhe unë e ndjej veten atje, shokë, me ju;
ndjej gëzimet e shqetësimet,
zërat e hapat tuaj e ju shoh
kur shkundni dëborën te dera e mensës
e tek gërmoni nga shkëmbi bauksitin,
ashtu si po gërmoj unë nga zemra,
këto fjalë të thjeshta për ju, shokë.

D E B O R A

Kur ra dëborë, fëmijët e gëzuar menduan se si të
kapnin zogjtë,
vajzat diçka të bukur menduan për dashurinë si
të ishin poete,
nënët, gjahtarët, punëtorët e minierës tjetër gjë
menduan
nga fëmijët që ëndërronin të binte 10 metër, 20 e
më
dhe t'i mbulonte pemët, udhët, shtëpitë, si në
përralla të bukura,
gjithçka të bëhej e rrafshët, sa me një sajë të
mund t'i silleshe globit,
e nën duartrokëtje prapë të kthehetë te dera he-
ronj...

KENGËT POPULLORE

Ato janë si lugina të thella,
ku jehon zëri i popullit tim,
ato vijnë që larg nëpër kohra,
herë sjellin mall, herë trishtim.

Udhës' gjatë kohrave nga vijnë,
bie borë, shkrepëtijnë rrufetë,
dhe ashtu si nga një derë stani,
hyjnë në zemrat tona lehtë, lehtë.

Kanë qeleshe, opinga dhe armë,
nuk durojnë t'i qeshë kush aspak,
bisedojnë me nipat deri vonë,
nëpër shekuj ecin, ecin larg...

DITËN E NJË MAJIT

Ditën e Një Majit i gëzuar e hapa derën,
kravatën e lidha shpejt, të gjitha mbetën prapa të
heshtura,
brohoritjet përhapeshin dhe zemra në gjoks ndjehej
naive si një fëmijë.
«Edhe një hap ka rëndësi, mendoja, edhe një broho-
ritje ka rëndësi,
brenda mund të kenë mbetur vetëm ndonjë gjyshe
dhe ndonjë foshnjë,
të dy ekstremet e jetës...»
Dielli më dukej krejt i afërt,
në mendje më rrinin të gjitha qytetet e botës, të
kuqe e të dallgëzuara,
ti ishe kudo e dashur atë ditë dhe s'kisha ku të
kërkoja.
Janë ca gjëra në jetë, përparrë të cilave edhe zemra
e burrit bëhet fëmijë.

Të kalosh përpara tribunës dhe të përshëndesësh partinë me grushtin lart,
«edhe një hap ka rëndësi, mendoja, edhe një brohoritje ka rëndësi...»

ME NE DO TË VISH, FIERZË

I

Natë!

Ende janë silueta gjërat.

Ne ecim drejt Fierzës,

radhë-radhë

konture gjysmë të fjetura...

Dhe në këtë errësirë,

që gjithnjë e më shumë po e prish agimi,

nis kënga ime për ty.

Me ne do të vish. Fierzë!

Nëpër këto vija nate,

n'imagjinatë,

unë lexoj lirinë shqiptare,

diagramë e saj,

enigmë e padeshifruar kurrë dot nga armiku.

Dhe këtu mes tyre,
do të çelë si një lule,
si një trëndafil i bukur drite,
një hidrocentral vigan,
Bota ka më shumë dhe më të mëdhenj,
e dimë,
por i bukur dhe kuptimplotë do jetë për të
gëzimi i popullit tim,
Dhe do na duhet kjo dritë,
për t'i lexuar më mirë,
këto konture të sarta të maleve gjyshër,
të ardhmen tonë dhe të shkuarën.

II.

Sheh kudo
diçka të shkruar shpejt
si me nervozizëm,
mbi dru, mbi beton
dhe kuption
se diçka lëviz, vetëtin,
te këto germa dhe fjalë,
më shpejt se koha,
më shpejt se ujrat...

Fierzë!
Si t'ua shpjegosh njerëzve

këtë emër?

Atje ku kish errësirë,
ne dritë kemi zbuluar;
në çdo emri dhe fjale,
kuptimin i kemi ndrruar.

Digë pas dige,
duke u ngjitur përpjetë,
rrjedhës së kohës,
rrjedhës së lumenjve.

III.

Jo, ti nuk mund ta dish
lulëzimin e ëndrrave të punëtorëve,
nuk mund ta dish kurrë,
se ç'janë ata dhe partia,
se ajo gjë në mes tyre
është shpërthimi i drithës më të bukur...
Këtu më shumë se zakonisht
duhet t'i kërkosh vetes
e artit tënd diçka të re.
E të zbulosh se këtu diçka më e madhe po
ndodh,
më e madhe se sa ajo që duket,



mes zemrave të njerëzve, mes duarve të tyre,
mes poezisë dhe realitetit.

IV

Një vajzë punëtore kalon në rrugë duke qe-
shur
dhe unë kuptoj se ende
ka diçka të vrenjtur te malet për të.

Dhe unë hyj në bisedë intime me malet,
me malet që lindën gjithmonë këngën e tri-
mërisë
e dua t'u gjej gjuhën, të mos i fyej,
duke qenë i pakuptueshëm për ta,
sepse e di mirë se s'është gjë që të binden
lehtë
se kjo vajzë është trimëria dhe kënga e tyre
bashkë.

V

Shkatërrojmë përditë diçka të vjetër,
të shëmtuar,
ndoshta edhe për këtë buzëqeshje të çiltër
vajze.

Lumi Drin rrjedh i turbullt përposhtë;
 këtu te kjo grykë
 kanë ulërirë erërat shekuj me radhë,
 dhe korbat kanë krakëllitur mbi vetminë e
 madhe
 dhe ka mbetur emri i lumit Drin në një këngë
 vaji.

i mallëkuar nga një nënë që ka mbetur pa
 djalë,
 i mallëkuar nga një motër që ka mbetur pa
 vëlla.

Se si më kumboi në veshë tani ajo këngë,
 tek minat pëlcasin dhe shkëmbinj hidhen në
 erë,
 dhe m'u duk se diçka u hodh në erë edhe tek
 ajo këngë,
 shkëmbi i trishtimit mbi zemrën e nënës e
 motrës
 me hijen e tij të gjatë e të rëndë.

Dhe kam një gëzim të madh në vete,
 maleve u flas, kontureve, krismave të moçme,
 u flas valëve, shkëmbinjve, pishave të larta,
 thellësive të tokës nënë
 dhe lartësive të saj,
 i flas së ardhmes që këtu e ndjen aq afër,
 dhe kam sot një gëzim të madh në vete,

gëzimin e fjalës që e ngritëm
mbi piedestale drite.

E jam pushtuar nga mijëra imazhe të bukura,
kam gëzimin e poetit që ka gjetur,
të vërtetën e poezisë së tij,
gëzimin e poetit që u këndon krenarisë së
maleve
dhe krenarisë së njeriut.

HAPAT QË LINDIN QYTETE

Gjeologëve

Ata të parët kalojnë,
hapat e tyre të parët shkelin,
të pashkelurën,
dhe janë krenarë për këtë
dhe, po të rrish me ta,
mund ta zbulosh lehtë këtë ndjenjë.
Hapat e tyre kanë një veti të çuditshme,
lindin qytete me një jetë të stuhishme,
me vajza të bukura, uzina e bulevardë të gjera.
Hapat e tyre gjithmonë pararendës.

UNË, FSHESARJA DHE KOMUNIZMI

Natë,
ftohtë,
era fryn;
në dhomën e hotelit,
mbi një letër,
përpiqem të shkruaj diçka.
Poshtë në asfalt
fshesarja fshin,
ngrihem te xhami dhe e shok
dhe një ndjenjë keqardhjeje
fillon të më hyjë te poezia,
po një zë ndjej nga larg:
«Dikush do t'i fshijë edhe rrugët e mia»!
Dhe ndryshe vjen tek unë,
zhurma e fshesës;
ora e qytetit troket 12
si këta dy akrepë që u puthitën,
drejt 12-tës së komunizmit,
pena dhe fshesa do të lëvizin.

DESHA TI TË LEXOJE DIÇKA NGA UNË

Zemra ka nevojë t'i shprehet dikujt,
njeriu duhet të jetë në vetvete krejt një kaltërsi.
Të mos shprehesh, do të thotë të jesh burg
dhe të jesh burg, do të thotë të jesh vetmi.

Cdo ditë edhe bota në tërësinë e saj sublime,
s'bën gjë tjetër veç veten shpreh më shumë,
gjersa veten plotësisht do ta shprehë në komu-
nizëm,
dhe unë... desha diçka ti të lexoje nga unë.

NET TRAKTORESH

Ai në 12 të natës u fut në dhomë,
Zhurma e traktorëve krejt fshatin e kish mbuluar,
hynte në vrimat e mureve të vjetra të shtëpive,
në gjumin e pleyeve, ku shekuj të zymtë lëroheshin,
u shtri në krevatin e drunjtë ashtu pa u zhveshur,
dhe s'e merrte gjumi; qindra mendime e kishin
mbuluar,
diçka e madhe po ndodhë këtë natë, ai e dinte,
po zhdukeshin megjët, nëpër pllaja kish dhembje,
gurët e bardhë nëpër ara dukeshin si kafka.
Ai në krevat mendonte vetëm për pleqtë,
te tokë dhe tek ata po ndodhë e njëjta gjë,
se të dy palët e kishin vështirë ta kuptionin ko-
munizmin.
Dhe gjithë natën në mendimet e tij sikur kuvendoi
me pleqtë,
dhe kish besim se ata do ta donin edhe më shumë
tokën.

D A S H U R I A

Dalngadalë gjithçka u mbush me shushurimë,
si pylli që nën erë e humbet qetësinë,
ditët e mia që kishin ikur duke pritur diçka,
si piano mbi ca nota të të cilave asnë gisht nuk
ishte ulur,
ti erdhe një ditë te dashuria ime për njerëzit,
pjesë e saj e bukur apo ndoshta simbol i së gjithës,
kisha harruar krejt se si dhuroheshin lulet,
s'e dija ç'do të thoshte të përkëdhelësh si fëmijët
një kukull llastiku (djalë a vajzë) lakuriq
gishtat e tu ua kishin vjedhur fuqinë krejt gishta-
ve të mi.

VARGJE NË VENDLINDJE

Po ti ku ishe atë kohë,
vendlindja ime e vogël?
T'u shtua edhe zëri. im
në zërat shekullorë,
vendlindja ime analfabete,
vendlindja ime me qeleshe!
Dhe nëna e mbuloi vatrën me hi,
që prapë mëngjesi i ri, që vinte, t'i gjente gjallë
thëngijt e jetës.

Dhe zbardhëlloi një ditë e madhe,
kur gjithçka merrte një kuptim të ri.
Dhe ti, vendlindja ime,
që i dhe komunizmit
çka pate më të shtrenjtë,
bijtë e bijat e tua.
Dhe ai të dha pranverën përtëritëse
me burimet, me përrenjtë,

me pyllin e gështenjave e me bimët,
me lulet e mollëve dhe zefirin,
ndërsa përzihej zëri im i mprehtë
me erërat e fortaj që po fyrnin.

E rriddhnin vitet pa pushim
si gurrat e lumenjtë e vendit tim.
Dhe unë rritesha e rilindesha përsëri
më shumë se nga barku i nënës, nga barku i kohës
edhe me sy të tjerë vëreja botën:

Një natë... Ç'ishte vallë ajo natë?
Oh, ç'mysafirë kishin ardhur në shtëpinë tonë?
Ç'opinga ishin mbledhur pranë derës,
sikur të kishin zbatbur opingat të gjitha vitet
e kishin ardhur që të kuvendonin!
Biseda, zhurmë, zëra të panjohur.
I dridhej nënës nëpër duar tabakaja e kafesë,
se ndjenj' e pronës ishte shumë e lashtë
edhe diku në shpirtin e tim eti,
lëshonte hije plepi i saj i gjatë
dhe zëri i saj si delja blegërinte në zemër edhe
në ahur.

Dhe jashtë në oborr në hunj të lidhur,
si njëzet kuaj të bardhë tundnin bishtin,
njëzet-tridhjetë shekuj.

Dhe ditët më të kthjellëta u bënë.

Dhe netët e vendlindjes u mbushën me zhurma
traktorësh,

që tog me arat lëronin edhe mendimet e pleqve.

Dhe hëngrëm bukën e parë, bukën socialiste,
krijuar nga mundimi dhe djersa e të gjithëve,
paçka se dikujt ajo s'i shijonte,
si buka e çerepit.

Dhe të gjëzuar i pashë fshatarët e mi,
që dikur e mbanin këmishën me njëmijë arna
sikur të mbanin mbi shpatullat e tyre
hartën koloniale të Afrikës.

Dhe kështu në vendlindje mësova
të isha poet i dritës dhe i djersës.

Dhe shkrova për gjëra të besueshme,
dhe njeriut nga zemra si njeri i fola...

Dhe vendlindjes i këndova nga vendlindja ime,
dhe nga vendlindja ime i këndova botës.

LE TË VIJNË BREZAT

Le të vijnë brezat,
çaji mbi stufë dhe arti,
njëlloj do t'i presin.

Le të vijë vazhdimi ynë,
një rrudhë nga fytyra jonë,
le ta kenë përgjithmonë në fytyrë,
atë rrudhë që te ne skaliti koha,
dashuri të pamposhtur për komunizmin.
Të ecin në ato udhë, ato shkallë, ato dhoma,
librat tanë duke hapur të bien në mendime,
le të vijnë si krijues dhe kritikë,
dhe le të prishet nëpër skeda gjumi ynë,
nën gishtërinjtë e tyre poetikë.

VALBONA E KALTËR

Eshtë një lumë
në vendlindjen time,
i vogël,
por shumë i kaltër,
i vogël,
por shumë i kthjellët,
është një lumë,
që quhet Valbonë.
Fare pak duket në hartë.
Misisipi, Nili, Vollga janë madhështorë...
Por ai s'mërzitet, rrjedh i qetë,
duket e di që bota
gjëra madhështore ka plot,
por gjëra të kthjellëta e të kaltra më pak.
Eshtë një lumë i kthjellët,
në vendlindjen time,
që quhet Valbonë.

DHE DETI KISH HESHTUR KREJT...

Një djalë e një vajzë erdhën e u ulën buzë detit, djali i hoqi këpucët, dukej i lodhur, i kapitur për gjumë, ndërsa vajza e çlodhur, e freskët, qeshte me kë-putjen e tij. Ai u shtri në rërë, u rrrotullua dy-tri herë, s'i flihej, pastaj vu kokën në prehrin e vajzës dhe më s'u ndje, dhe deti kish heshtur krejt, që mos t'ia prishte gjumin.

TI DHE BREGDETI

Fund vjeshte, eci mbi rërën e imtë të plazhit.
Ku ikën njerëzit, ditët me syze ku ikën?!
Të zymta murmurisin te takat e këpucës valët,
lozin me njëra-tjetërën batica me zbaticën.

Te një kokrrizë rëre përpinqem të të përfytyroj ty
me syze,
të gdhend buzëqeshjen që rëra ma fsheh me cini-
zëm,
trupin e bukur me ca vija që bazohen s'di në
ç'ligje,
ku hyjnë dashuria bashkë me kibernetikën.

NË DHOMËN KU LINDA

Në dhomën ku linda dikur po rrija
Kur dëgjoj befas të qarën time,
nëpër dhomë përhapej valë-valë,
dilte e qara ime nga muri i bardhë,
nëpër shtresat e holla të gëlqeres derdhej,
fëmijnia ime e dikurshme, e ikur.
Kur papritur nëna hyn në dhomë,
sikur edhe ajo të kish dëgjuar të qarën time,
duke mbajtur një filxhan me qumësht në dorë:
— Na, pijë, bir!
Dhe papritur ndjeva se isha i rritur.

PRANE NËNES

Pranë meje qëndron ti, e thinjura, e urta, e
shtrenjta,
dhe nën vështrimin tënd kam rënë në mendime.
Përjashta të heshtura janë pemët, toka, bari,
trazon muzgu hijet në muret e dhomës ku më linde.
Dhe duart e tua të plakura mbi gju m'u dukën si
pellumbë,
që papritur i zu gjumi i ëmbël.

G J Y S H J A

Mërzitet gjyshja shpesh,
nën çatinë e thinjave të saj,
mbështetur me të dyja bërrylet,
në parvazin e së shkuarës.
Dikush i thërret, dikujt i thërret.

Macja, kujtimet dhe mbesa e vogël,
janë tani ditët e saj të thinjura,
sepse revolucioni ynë la pas shumë kujtime,
shumë kujtime të zymta e të hidhura.

Kanë ikur nipat, mbesat larg,
por se ku, nuk dinë t'ia shpjegojnë,
mërzia e saj atje në atë parvaz,
e di, kurrë s'e fyen rrugën tonë...

P E M E T

Ato kudo më kanë ngjarë
me nënët, me motrat, me të dashurat,
kudo më kanë pritur, përcjellë e përshën-
detur,
pas xhamit të ndarjes plot rrëkera shiu,
ato gjithmonë mbajnë diçka nga njerëzit,
pemët...

N J Ë D I T E . .

Dikur e kishim vështirë që t'i shprehnim një vajze
dashurinë,
dikur e kishim vështirë të jepnim një mendim pér
botën e madhe,
dikur e kishim vështirë ta çonim gjer në fund fry-
mëzimin e një vjershe,

por erdhi koha që të na pushtojnë shqetësimet e
dashurisë
dhe e ndjemë se shumë gjëra të bukura mund t'i
thoshim vajzës;
dhe e pamë se mund të thoshim diçka dhe ne pér
botën,
dhe vumë re se mund të bënim diçka pér komunizmin,
dhe pas të gjitha këtyre e kuptuam fare mirë
se frymëzimin mund ta çonim gjer në fund të
këngës.

MESNATA E KËTIJ QYTETI

Eshtë i çuditshëm gjumi,
në këtë qytet që ka jastëk te koka detin.
jastëk i zhurmshëm e i shqetësuar.
Në sheshin e tij-ku digjet mesnata,
me parullat e kuqe të Partisë
nxjerr kokën i hutuar muri i një kështjelle të
vjetër,
në gjinë e tij nxjerrin kokën silueta anijesh
dhe elektrovinça si kafshë cirqesh, që bëjnë humor
me yjet
dhe ushtojnë zëra punëtorësh e sirenash.
Eshtë i bukur gjumi
në këtë qytet që ka jastëk te koka detin.

L A P I D A R I

Atje në bjeshkë është një lapidar i bardhë,
mes asaj vetmie epike ku endet veç ushtari,
me një automatik e ca fotografi në xhepin e
gjelbër,
ai u ngrit si përmendore e pesë ushtarëve,
rënë në krye të detyrës në një dimër të egër.

Kush mund të thotë gjithçka pér rënien e tyre,
se si ecnin të mbështjellë me mjegullën e bardhë të
vdekjes,
se si murlani i frynte si një fëmijë fijes së shkre-
pëses,
teksa përpinqeshin të ndiznin një mëngë të grisur
këmishe,
që të mund të çmpinin pak duart që mbanin me
zor automatikun,
në dejet e të cilave ndesheshin në mënyre titanike
dashuria pér atdhenë dhe vdekja.

Se si binte i pari në borë i këputur, si pa kuptuar,
se si e tërhiqnin shokët që të mos ia linin vdekjes,
e kështu me radhë njëri-tjetrin,
gjersa të fundin
s'do të kish më kush ta merrte.

Se si zbrazej një automatik i tërë në ajrin e mje-
gullt,
duke mbetur pas tek-tuk si të plagosura edhe
gëzhojat,
dhe asgjë veç qetësi e bardhë e vdekjes,
që gojën i kish mbyllur gjithçkaje,
dhe shkëmbinjve, dhe shpellave;

dhe në pranverë fëmijët e vegjël çobanë,
ato gëzhoja do t'i gjenin dhe do t'i çonin nëpër
stane,
por fjalët që u thanë në çastin e vdekjes,
kush mund t'i dijë, poet, përveç stuhisë noprane?

Atje ku atdheu në gjuhën e stuhive u flet
dashurive,
kush mund të dijë,
se sa i ëmbël është gjumi në dëborë,
se si dëbora prebatiste për ta një savan të bardhë,

se si majat e maleve netve krenare dhe të heshtura
mbanin mbi supe qivuret e tyre madhështore?

Se si vdekja ikte e trembur nga ato jehona,
me atë manjetofonin e saj të lashtë shpellë më
shpellë.

duke qëndruar një natë përpara lapidarit të tyre,
duke mos e kuptuar kurrë alfabetin e bukur të
njerëzve,
ajo vdekja e mundur nga shqiptari gjithmonë.

LETRA E NËNES

Dëshiron të më shkruajë një letër, por s'di të
shkruajë,
e nga dëshira dhe malli i zemrës lindi befas një
fëmijë,
që nëpër gishtérinjtë e saj zgjatet e merr formë
kaçurreli i tij i vogël...

Një fëmijë me një penë në dorë,
që e njom një herë në dy-tri fjalë,
me një letër të bardhë përpara ku lëviz hija e
bërryli,
dhe ai vogëlush gjithnjë mbetet në klasën e parë,
shokët e tij ikin, ngjiten nëpër shkallë të gëzuar...
Dhe rriten e rriten,
dhe gjithnjë aty mbetet ai vogëlush i çuditshëm,
mes djalit dhe nënës, mes nënës dhe djalit,
duke shkruar me vëmendje çdo fjalë,
nëna flet dhe ai shkruan... gjithnjë... gjithnjë...

DJALI I VOGËL NË KANTIERE

Ecën ngadalë në rrugën plot diell
me një çap të lumtur e të shkurtër
vogëlushi në kanatiere,
duart pas si një i madh i lidh,
pastaj e shkëput njëren dhe e tund serbes
dhe unë kënaqem duke e soditur
dhe pyes veten: «Kush mund ta dijë vallë
se kush e pret vogëlushin dhe ku e pret?
Të thuash: cicërimat e zogjve,
të thuash dielli? Kushedi.
Të thuash ajo melodi
që i ngatërrohet nëpër gojë?
Apo ndoshta gjithë bota? Mundet.»
Ecën vogëlushi:
Me të dyja format e shpatullave
që ia ka nxirë dielli,
n'atë moshë që njeriu s'di ç'lë pas,
dhe as di ç'e pret përpara.
Dhe s'di se pse ne shohim fëmijninë tonë.

Dhe qeshim me ecjen serbes, me tundjen e dorës
si një i madh shumë i vogël,
si një i vogël shumë i madh...

Dhe unë desha të gdhend ecjen e tij,
por si mund të gdhendet një portret kaq i

bukur?

HIMN I PAMPOSHTJES, VIETNAME

Për shumë kohë u mësuam me ty, Vietnam!
Të patëm mik të mirë,
të mëngjeseve dhe të mbrëmjeve tona.
Hanoi ishte bërë pér veshin tonë e pér vetëdijen
kryeqyteti i shqetësimeve të ndershme të botës.
Portreti yt i çuditshëm i ditëve.
Por pse them i çuditshëm?
Te ti gjithçka ish e qartë si dhembja e plagës,
si forca e dashurisë dhe lulëzimi i tokës,
por prapë ti mbete disi i çuditshëm,
se lulet, dashuria dhe zjarri u bënë te ti një.

E dinim se ti ishe i pamposhtur.
Vietnam, shumë gjëra të bucura ëndërruam në
hartën e botës,
asnje vijë të padrejtë mbi ndarjen përgjysmë të
zemrës,
Vietnam i shpërndarë mbi glob me radiovalë
parreshtur,

ndër kolona gazetash, nderje tragjike nervash!
Gjithnjë i kemi takuar me ty sytë, duart, zemrat,
lulet dhe plagët e tua me respekt i kemi prekur,
Vietnam!

Liriket e këtij mësimi i shndërrimit të

“Bën që dritën mëngë”

sidoli sive mësuesit është evangjeli i
muzikave së vjetra, o bazu mëdha ushqyeshëse tonale
zëfishtë e mësimdhënësve e rreth mekipa t’i përzgjedh

“Bën që dritën mëngë” i mësimdhënësve

zëfishtë e mësimdhënësve që këtë mësimdhënie e

“Bën që dritën mëngë” e përmendin

VARGJE PARTISË

Cila je ti,
me ty mua ç'më lidh,
mua, njerinë?
Endrrat e mia prej njeriu.
S'është aq zor të hash një copë bukë,
në lëkurën tënde të jetosh mirë
e të numërosh ditët si tespihe.

Cila je ti,
me ty mua ç'më lidh,
që nga njeriu primitiv,
nga skllavi gjer tek unë,
ja, tek po eci në rrugë;
të verbra s'do të jenë hapat e mi,
në botën e gjerë,
dritare e bardhë je ti,
Parti!

Ajo,
që unë mburrem me këngën e partishme,
ajo që armikun e njoh,
dhe me të ndeshem,
sado i madh qoftë,
afër apo larg,
qoftë edhe brenda vvetes,
pa u gënjer me përrallat e tij të «bukura».
Ajo që më bën mua ushtar e njeri,
je ti, Parti.

Më lirshëm
do të dëgjoj hapin tënd, shok,
në asfalt çdo natë
dhe do të rri pas dritares sime,
duke menduar epopenë vigane,
të hapit tënd punëtor.

Çdo ditë më shumë,
do të jesh mes nesh
e do të zësh më tepër hapësirë
nëpër faqet e librave
e nëpër këngët e ditëve.
Në bulëzat e djersës së punëtorit
që shemb dhe ndërton mrekulli,
të shoh, ty, Parti.

G E S H T E N J A T

Të ecësh nën drurët e gështenjave në vjeshtë,
është një gjë e mrekullueshme, vërtet,
pikojnë kokrrat mbi ty nga boçet e çara,
bien me një zhurmë të lehtë gjethet e thara,
drurë të mirë, drurë të mirë, gjithmonë ju desha,
drurë të fëmijnisë sime, që më bëtë poet,
e si të mos shkruaja për ju disa rreshta?

NJOH CA NJERËZ

Njoh ca njerëz,
ditën e punës e fillojnë të qetë,
me kafe, me cigare, me një bisedë
për fluturimet në Hënë, për boksin, për televi-
zionin...

Njoh ca njerëz
të hekurosur shik, të lyer, të larë dritë
dhe fjala e llastuar nga goja u del si karamele,
pompozë në paraqitje, herë-herë flasin dhe me ton
për revolucionin
thuajse njëzet plagë kanë marrë për të në trup,
thua sikur vetëm për të të jetonin.

Njoh ca njerëz,
që, po t'i kritikosh, turinjtë fryjnë tmerrësisht,
s'të flasin shumë ditë dhe të shikojnë tërë ironi.
Kur flasin, patjetër duhet t'u buzëqeshësh,
t'u aprovosh çdo gjë, se ndryshe ua ke prishur
rëndë qejfin.

Dinë se si të përpiken që mirë ta kenë me drejtorin
e me shefin.

Njoh ca njerëz,
që hiqen modernë, gjuhën përpiken ta kenë sa më
delikate,
dhe me një zotësi të çuditshme dinë udhëkryqeve
t'u shkasin,
shpesh papritur bëhen të heshtur, nuhasin shumë,
më shumë se bretkocat që parandjejnë shinë.
Dhe, kur parandjejnë ndonjë gjëmim të klasës,
ndryshojnë menjëherë,
bëhen tmerrësish të sjellshëm dhe tmerrësish
aq sa duken të mjerë e komikë.

Njoh ca njerëz...

KËNGË PËR PRANVERËN

Natë, çelin lulet,
nëpër sekonda hapen gonxhet.
Dhe nën këtë shpërthim të papërmbajtur,
kjo natë duket si një gjoks i zbërthyer, i lumtur
prej ëndrrave të pafundme.
Dhe nuk është e thjeshtë kjo natë...

Celin lulet,
nëpër sekonda hapen gonxhet.
Është e ngrohtë kjo natë;
ëndrrat nuk ngrijnë në të,
mbi to nuk frys cingërimë
dhe frymëzimi vjen i lumtur.
Nuk është e thjeshtë kjo natë,
në këto gonxhe çel koha me lulet më të bukurë
të pranverës së saj më të bukur,
që është buzëqeshja e njeriut...
dhe e atdheut tim të dashuruar.

Atdheu im i vogël,
e ç'rëndësi ka në këtë pranverë,
i madh apo i vogël; rëndësi ka,
asaj t'i përkasësh, të lulëzosh e të jesh i lumtur,
të kesh buzëqeshjen e saj në shpirt.
sepse në të kudo janë pafundësitë.

Po në këtë natë të bukur të dashurisë sime,
dua të dal të përshëndes njerinë,
hapat dhe zërin e tij të lumtur,
duke kaluar ndanë xhameve të dritares sime në
rrugë...
Hapat e tij që kanë lënë nëpër kohëra gjurmë të
mëdha,
dhe bulëza gjaku në lëndinat e në këmishën e tij
të përgjakur,
gonxhe që kërkonin këtë natë pranvere,
këtë natë të ngrohtë si një gjoks i zbërthyer,
prej èndrrave të pafundme.

Të puth njerinë. «Njeri!» të thërras i lumtur,
unë, poeti, që shkruaj sonte për pranverën këtë
këngë,
duke parë në hijen e penës sime që lëviz,
njerinë e kërrusur në shekuj mbi mendimin
për të thënë diçka për këtë pranverë.

Unë, poeti,
në këtë natë të bukur të pranverës sime,
kur shpirti im i lumtur thërret: «Njeri!»
në këtë natë më të ndjeshme se gjysmëpërçuesit,
kur unë e atdheu im i përkasim pranverës më të
bukur të kohës.

M A R I N A R E T

Ata e dinë se ç'është në një bregdet të dashur
silueta e së dashurës, që tretet dalngadalë;
ata e dinë ç'janë brigjet e ndarjet,
që vetë i bashkojnë e i ndajnë përherë.
Më mirë se ata s'i njeh kush dallgët e detit,
ndaj ndodh të kenë kaq humor e kaq gaz në sy...
Bishtat e cigareve që pinë mbeten në Bosfor e
Gjibraltar,
drejt atdheut një delfin gjithmonë u prin.

EUGJEN POTJESË

Kur njoha emrin tënd, Eugjen Potje,
e desha Francën më shumë,
e di, sot në botë dikush u këndon mikrobeve,
por «Internacionalja» është një det që nuk
njeh gjumë.

LE TË PËRGJAKEN KLASAT NË NDËRGJEGJEN TIME

Ashtu tinzar, gati si pa u ndjerë,
armiku kërkon të hyjë në ndjenjat dhe mendimet
e mia,
po unë atë e përzë, e ndjek pa mëshirë
me këngën më të bukur që shpirti më mban
ndezur,

PARTIA.

Me thikë dhe bajonetë
le të përgjaken klasat në ndërgjegjen time,
i tillë le të jem poet ndër poetë,
dhe më të bukur se kërkoj fjalën time.
Dëgjoj vazhdimisht zëra,
që kënga ime ta humbasë tonin,
i njoh fort mirë këto zëra,
dhe u' zë fytin pa mëshirë.
me këngën më të bukur që shpirti më mban ndezur,
REVOLUCIONI!

VUAJ VAZHDIMISHT PËR NJË FJALE...

Jo, nuk është kjo një vuajtje alkimisti,
le të jetë fjala e thjeshtë ashtu siç është dhe e
hijshme,
por kërkoj vazhdimisht më shumë dashuri të ketë
për njerinë,
për tokën, për lulet, për punën dhe partinë.

Vuaj që të jem tërësisht te fjala dhe qenka e
vështirë,
sepse ne jemi njerëzit që transformojmë gjithçka,
natyrën, shpirtin, sigurisht dhe poezinë.

PASQYRA E LËNDËS

	faqe
Bjeshkët	3
Xhaketa me mëngë të shkurtëra	4
Komuna e Parisit	6
Në prag të Vtit të Ri	7
Mos e lejo...	9
Minatorëve të Valbonës	10
Dëbora	11
Këngët popullore	12
Ditën e Një Majit	13
Me ne do të vish, Fierzë	15
Hapat që lindin qytete	21
Unë, fshesarja dhe komunizmi	22
Deshë ti të lexoje diçka nga unë	23
Net traktorësh	24
Dashuria	25
Vargje në vendlindje	26
Le të vijnë brezat	29
Valbona e kaltër	30
Dhe deti kish heshtur krejt..	31
Ti dhe bregdeti	32
Në dhomën ku linda	33
Pramë nënës	34
Gjyshja	35
Pemët	36

faqe

Një ditë...	37
Mesnata e këtij qyteti	38
Lapidari	39
Letra e nënës	42
Djali i vogël në kantiere	43
Himni i pamposhtjes, Vietnamit	45
Vargje Partisë	47
Gështenjat	49
Njoh ca njerez	50
Këngë për pranverën	52
Marinarët	55
Eugen Potjesë	56
Le të përgjaken klasat në ndërgjegjen time	57
Vuaj vazhdimi shqiptar	58